



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

Shënoni një përmbledhje të shkurtër të programit!

**VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË EKSPERTËVE**

*(Të vlerësohet nëse rekomandimet e dhëna nga ekspertët ndërkombëtar janë implementuar)*

Nga rekomandimet e eksperteve ndërkombëtar sipas fushave të paraqitura ne RVV:

**Misioni, objektivat dhe administrate (4 rekomandime):**

- 3 rekomandime të implemtuara,
- 1 në proces të implemtimit (ky rekomandim ka të bëjë me hartimin e planit strategjik të fakultetit. Për këtë deri tash është formuar komisioni për hartimin e planit strategjik për Fakultetin e Agrobiznesit

**Menaxhimi i cilësisë (6 rekomandime):**

- 3 rekomandime të implementuara
- 3 në proces të implementimit

**Stafi akademik (4 rekomandime):**

- 2 rekomandime janë implementuar
- 2 rekomandime në proces

**Përmbajtja e procesit arsimor (10 rekomandime):**

- 3 rekomandime janë implemtuar
- 5 janë në proces të implementimit
- 2 nuk janë implementuar

**Studentet (9 rekomandime):**

- 7 rekomandime janë implementuar
- 2 në proces të implementimit

**Hulumtimi (6 rekomandime):**

- 1 rekomandim i implemtuar
- 4 në proces të implementimit
- 1 nuk është implementuar

**Infrastruktura dhe burimet (5 rekomandime):**

- 2 rekomandime janë implementuar
- 2 në proces të implementimit

**EVIDENTIM TË PJESËMARRJES SË STUDENTËVE NË LIGJËRATA**

***(Të vlerësohet duke krahasuar numrin e studentëve të regjistruar në program me numrin e studentëve pjesmarrës në ligjerata dhe ushtrime)***

Çdo vit akademik, regjistrohen 25 studentë në programin "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor". Gjatë periudhës së dy viteve akademike, që përfshin vitet 2021/22 dhe 2022/23, mesatarisht janë përfshirë në ligjërata dhe ushtrime mes 15 dhe 20 studentë për gjeneratë.

#### **KALUESHMËRIA E STUDENTËVE**

***(Analizoni kalueshmërinë për secilën lëndë dhe programin në përgjithësi, evidentoni shkallën me të ulët dhe me të lartë të kalueshmërisë)***

Nuk kemi të dhëna specifike për rreth kalueshmërisë për secilën lëndë.  
Sipas raporteve për regjistrim të semestrave aktualisht janë të regjistruar 43 studentë nga 2 gjenerata, 27 studentë gjenerata 2022/23 (duke i përfshirë edhe studentet që kanë përsëritur vitin) dhe 16 studentë gjenerata 2021/22  
Në këtë vit (2023/24) janë pranuar 23 kandidatë.  
Studentët e gjeneratës 2021/22 kanë përfunduar ligjëratat, aktualisht janë në vite të II-të, shumica e studenteve janë duke punuar temat e masterit, prej tyre deri tani:  
I diplomuar – 1 kandidat  
Kërkesë zyrtare për temë – 9 kandidatë  
Të tjerët janë në fazën e përgatitjes së projekt-propozimit për temë dhe në përfundim të provimeve të vitit të II-të.

#### **VLERËSIM TË SYLLABUSËVE**

***(Analizoni syllabuset e lëndëve për të parë nëse janë të strukturuar në mënyrë efektive, a janë përditësuar në dy vitet e fundit dhe a përfshijnë informacionin e nevojshëm për studentët)***

Syllabuset në këtë program janë të harmonizuara me syllabuset e një programi të ngjashëm që u zhvillua në kuadër të projektit STEPS. Ky program ka përfshirë Universitetin Haxhi Zeka (UHZ), si dhe universitete të tjera nga tre vende të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Kosova dhe Bosnja & Hercegovina), si dhe universitete nga tre vende të Bashkimit Evropian (Republika Çeke, Rumania dhe Greqia). Gjatë përgatitjes për procesin e riakreditimit (në këtë fazë jemi aktualisht), syllabuset do të përditësohen me të dhëna të reja. Ky harmonizim me programe të ngjashme dhe përditësimi i tyre me të dhëna të reja tregon një përpjekje për të siguruar që syllabuset janë të përshtatshme dhe të aktualizuara për studentët. Prandaj, ato përfshijnë informacionin e nevojshëm dhe janë të organizuara në mënyrë efektive për të ofruar një përvojë studimore cilësore

#### **VLERËSIM TË LITERATURËS SË PËRDORUR, MUNGESAT E VËREJTURA DHE MASAT PËR PËRMIRËSIM TË SITUATËS;**

***(Siguroni nëse literatura dhe burimet e përdorura në program ekzistojnë, është bashkëkohore dhe jo më e vjetër se dhjetë vite, dhe identifikoni mangësitë gjatë këtyre viteve)***

Në analizën e 23 syllabuseve të këtij programi, janë evidentuar gjithsej 139 burime të literaturës. Prej të cilave, 86 janë përcaktuar si literaturë obligative, ndërsa 53 burime janë të përfshira si literaturë shtesë. Gjithashtu, është vlerësuar se përgjithësisht literatura, veçanërisht ajo e obligative, është e vitit të fundit, me disa përjashtime.

Në përgjithësi, ka disa mangësi që duhet adresuar. Disa burime të literaturës nuk janë të shoqëruara me informacione rreth viteve të tyre, ndërsa në disa kurse ka përshtypjen se është propozuar një numër shumë të madh i librave të detyrueshëm dhe shtesë, që duket të jetë një barrë e tepërt për studentët.

Për të përmirësuar situatën, duhet të ndërmerren masa të caktuara. Është e rëndësishme të rishikohet kujdesshëm literatura në të gjitha kurset, për të siguruar se ajo është e përshtatshme me ngarkesën e studentëve dhe me qëllimin e secilës lëndë. Po ashtu, duhet bërë një vlerësim i hollësishëm i rezultateve të të nxënësve për të përcaktuar cilat burime janë më efikase në ndihmën e studentëve.

**REGJISTRIMI I STUDENTËVE NË RAPORT ME NUMRIN E SHPALLUR PËR APLIKIM, DHE FORMAVE TË TJERA, VARËSISHT NGA PROGRAMI I VLERËSUAR**

***(krahasoni numrin e shpallur për aplikim me numrin e studentëve që kanë aplikuar dhe numrin e të regjistruarve)***

Programi Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor është aktiv nga viti akademik 2021/2022 dhe deri tani janë regjistruar dy gjenerata. Në këtë program çdo vit akademik mund pranohen 25 student.

***Interesimet për regjistrim:***

- Viti akademik 2021/22: 51 kandidatë të paraqitur
- Viti akademik 22/23: 32 kandidatë të paraqitur
- Viti akademik 23/24: 23 kandidatë të paraqitur (në afatin e pare)

Plotësimi i numrit me kandidatë në këtë program në tri vitet akademike (2021/2022, 2022/2023 dhe 2023/24) është bërë në afatin e parë dhe nuk ka pasur nevojë për afate shtesë.

**VLERËSIM TË SHPËRNDARJES SË KREDIVE NËPËR LËNDË**

***(Vlerësoni se si janë kalkuluar kreditë për secilën lëndë duke llogaritur ngarkesën e studentëve për këto lëndë/program)***

Programi përbëhet prej 6 lëndëve obligative dhe 17 lëndëve zgjedhore. Të gjitha lëndët kanë nga 5 kredi, 90 ECTS kredit merren nga lëndët, 30 ECTS kredi për punën e temës. Të gjitha modulet janë vlerësuar sipas ECTS-standardeve.

**VLERËSIM TË LËNDËVE MËSIMORE**

***(Bëni vlerësimin e lëndëve të programit duke krahasuar se a përputhen me rezultatet e të nxënësve dhe si ndihmojnë tek studentët në zhvillimin, aftësimin dhe arritjen e njohurive të tyre. Siguroni nëse janë marrë parasysh kërkesat e tregut)***

Lëndët e programit "Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor" janë të projektuara për të përmbushur nevojat e studentëve, duke ndihmuar ata të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për të bërë një ndikim pozitiv në industri të rëndësishme të prodhimit ushqimor në kontekstin e qëndrueshmërisë. Për ndërtimin e objektivave të këtij programi, një kontribut të veçantë e ka dhënë edhe Bordi Këshillëdhënës i Fakultetit të Agrobiznesit që vepron në kuadër të fakultetit, i cili ka për qëllim të bashkërendojë kërkesat dhe nevojat e tregut të punës, bizneseve të regjionit me programet e studimit në fushën e agrobiznesit duke ofruar mundësi për studentët të kryejnë punën praktike në biznese, duke propozuar ndryshime për të avancuar programet e studimit dhe duke realizuar projekte të përbashkëta në mes të akademisë dhe biznesit.

**VLERËSIM TË ELEMENTËVE TJERA (LIGJERATA, PUNIME SEMINARIKE, PRAKTIKA, PROJEKTE, LABORATORË, ETJ)**

***(Vlerësoni se si elementët e cekura të programit kontribuojnë në zhvillimin e studentëve, a marrin pjesë studentët projekte, punë praktike....***

Aktualisht janë të përfshirë studentë në projekte dhe hulumtime shkencore se bashku me profesorë (6 studentë). Përfshirja e studenteve në projekte dhe hulumtime pritet të rrite gjatë realizmit të temave të tyre të masterit.

**VLERËSIM TË IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT DHE PLANPROGRAMIT TË STUDIMIT NË VITET PËRKATËS AKADEMIK;**

***(Të vlerësohet si është implementuar programi dhe planprogrami në vitet akademik përkatës, monitoroni përmbushjen e objektivave dhe a është zhvilluar sipas orarit programi)***

Programi është zhvilluar sipas orarit dhe janë përmbushur objektivat e parapara.

**VLERËSIM I FEEDBACK-UT TË MARRË NGA VLERËSIMI I BËRË ME STUDENTË, PUNËDHËNËS, INDUSTRIË ETJ**

***(Mblidhni informacione dhe vlerësime nga studentët, punëdhënësit dhe industrinë për programin dhe vlerësoni ato rezultate)***

Disa rekomandime rreth vlerësimit të këtij programit me student dhe akterë të tjerë:

- 1. Analiza e strukturës së programit:** Përpara se të aplikohet për akreditim ose riakreditim, aq sa lejohet të rishikohet struktura dhe kurrikula e programit. Të sigurohemi që programi të përfshijë lëndët dhe temat që janë me interes të studiohen dhe që ato përbëjnë një bazë të qëndrueshme për të ardhmen e studenteve dhe të institucionit. Të inkorporohet me tepër aspektet e qëndrueshmërisë tek disa lëndë, sugjerim nga ana e studentëve. Rekomandim tjetër nga ana e studentëve është se lëndët si psh.: Përdorimi i qëndrueshëm i produkteve për mbrojtjen e bimëve, shkenca dhe teknologjia e avancuar e ushqimit, cilësia dhe qëndrueshmëria e prodhimit të ushqimit nga resurset bimore, teknologjia e qëndrueshme e produkteve të pjekjes, teknologjia e qëndrueshme e prodhimeve të qumështit të rishikohen ose të zëvendësohen me lënë të tjera. Rekomandim tjetër lidhur me programin është angazhimi me tepër në punë praktike.
- 2. Resurset dhe infrastruktura:** Për një program të suksesshëm në këtë fushë, është e rëndësishme që të ketë akses në resurse dhe infrastrukturë të përshtatshme. Për shembull, laboratorët e përpunimit të ushqimit, fushat bujqësore, dhe teknologjitë e fundit janë të rëndësishme për studimin e qëndrueshmërisë ushqimore.
- 3. Mundësitë e punës praktikës dhe projekteve:** Programi duhet të ofrojë mundësi për praktikë ose projekte në mënyrë që ato rezultate të përdorni për të zhvilluar aftësitë praktike dhe për të aplikuar njohuritë e mësuara në situata reale. Përmes këtyre aktiviteteve studentet shohin si mundësi ndërlidhjen e mësimave teorike me punën praktike.
- 4. Ndërlidhja e programit të studimit me Industrinë (tregun):** Mundësitë që mund të ofrohen përmes punës praktike të studentëve në industri apo organizata të tjera, marrëveshjeve të bashkëpunimit, projektet të përbashkëta etj., aspekt i rëndësishëm për të siguruar që studentët

të jenë të përgatitur për sfidat dhe mundësitë e karrierës së tyre të ardhshme në fushën e Sistemeve të Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor.

5. **Vizitat studimore, mobilitetet me universitete apo institute:** Formë e mirë për të siguruar një eksperiencë të suksesshme gjatë studimeve në kontekst të përfitimit të njohurive të reja.